VENDIM
Nr. 238, datë 18.3.2015

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 834, DATË 21.11.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BERAT, TË QARKUT TË BERATIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja "e", 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Berat të pasurive me numrat rendorë 741, 742, 743, 744, 2949, 2950, 2951 e 2952, sipas formularëve bashkëlidhur, me qëllim ndërtimin e objekteve të Ujësjellës – Kanalizimeve sh.a., Berat - Kuçovë.

2. Të dhënat për pronat e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, pasqyrohen në listën bashkëlidhur vendimit nr. 834, datë 21.11.2012, të Këshillit të Ministrave, ndërsa pronat me numrat rendorë 2949, 2950, 2951 e 2952 t'i shtohen edhe listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore nën juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Berat.

3. Bashkisë së Beratit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia: **Berat**

Fusha e perdorimit te Prones: **Troje -Sheshe**

Identifikoi: **Sllavi DHRAMI** (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Meleqe Spahiu** (Drejtor i drejtorise se MPBSQS)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Fadil NASUFI** (Kryetar i Bashkisë)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

	A			B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2949	8501 A-4	19/63	Truall	Truall Lagja Barrikade	476		Sheshe	Bashkia Berat	Bashkia Berat	Zënë forcërisht
2950	8501 A-4	19/64	Truall	Truall Lagja Barrikade	28		Sheshe	Bashkia Berat	Bashkia Berat	Zënë forcërisht
2951	8501 A-4	19/66	Truall	Truall Lagja Barrikade	46		Sheshe	Bashkia Berat	Bashkia Berat	Zënë forcërisht
2952	8501 A-4	19/67	Truall	Truall Lagja Barrikade	285		Sheshe	Bashkia Berat	Bashkia Berat	Zënë forcërisht

21	8502 H-4	1/44	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve Lagja Kala Bashkia Berat	480	240	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	korigjin sip. Trualli ishte 375 behet 480 m², korigjin sip. objekti i ishte 175 behet240
24	8503 K-7,8	8/29,8/30	Truall Ndertese	Shkolla e Mesme Profesionale "Kristo Isak" Bashkia Berat	4270	1660	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	korigjin sip. Truall ishte 3200 behet 4270m², korigjin sip. objekti i ishte2092 behet 1660
29	8502 K-6,L-6	14/38	Truall Ndertese	Qendra Ekonomike Arsimore Bashkia Berat	1300	813	Administrate	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	korigjim I numrit te pasurise ishte 19/233 behet 14/38 indeksi hartes behet K-6,L-6 Zona kadastrale 8502
705	8501 J-4	17/213	Truall	Lulishte Lagja Muzakaj	1882		Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat	Korrigjimi i emertimit te pasurise nga truall ne lulishte
741	8501 A-4	19/61	Truall	Trualli Lagja Barrikade	710		Ambjent ndihmes	Bashkia Berat	Bashkia Berat	
742	8501 A-4	19/62	Truall	Trualli Lagja Barrikade	2645		Ambjent ndihmes	Bashkia Berat	Bashkia Berat	
743	8501 A-4	19/65	Truall	Trualli Lagja Barrikade	382		Ambjent ndihmes	Bashkia Berat	Bashkia Berat	
744	8501 A-4	19/68	Truall	Trualli Lagja Barrikade	1319		Ambjent ndihmes	Bashkia Berat	Bashkia Berat	
1191	8502 K-6	12/95 12/96	Truall ndertese	Shtepi Pionieri Lagja 10 Korriku Bashkia Berat	550	250	Kulture	Bashkia Berat	Bashkia Berat	korigjin sip. Trualli ishte 292 behet 550 m²: korigjin sip. objekti ishte 292 behet 250 nr.pasurise nga 12/95, behet 12/95, 12/96
1197	8503 K-8	7.142	Truall ndertese	Klubi shumsporte(mundje,gimnastik) Lagja kushtrim Bashkia Berat	680	570	Sport	Bashkia Berat	Bashkia Berat	korigjin sip. Trualli ishte 240 behet 680 korigjin sip. objekti ishte 240 behet 570 nr.pasurise nga 7/66, 7/68,7/69, behet 7/142
1200	8501 J-3	14/46 14/43	Truall	Kend sportiv Lagja Deshmoret e Kombit Bashkia Berat	2100		Sport	Bashkia Berat	Bashkia Berat	korigjin sip. Trualli ishte 1513 behet 2100 m², korigjim numri pasurise ishte 14/46, behet 14/43,14/46
1243	8503 k-8 J-8	9/85 9/58	Truall ndertese	Çerdhe nr.3 Lagja Donika Kastrioti Bashkia Berat	1070	280	Sherbim social	Bashkia Berat	Qendra Ekonomike Arsimore Berat	korigjin sip. Trualli ishte 400 behet 1070 m², korigjin sip. objekti i ishte 125 behet 280
64	8502 J-6	12/16,6 12/5	trotuar	trotuar Tek Bashkia Bashkia Berat	682		Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat	korigjohet liçi I prones nga truall ne trotuar dhe emertimi i prones nga lulishte ne trotuar
1231	8502 I-5,J-5	8/153	Truall ndertese	Tregu industrial ushqimor Lagja 13 Shtatori Bashkia Berat	920	920	Zhvillim ekonomik	Bashkia Berat	Bashkia Berat	Ndertese 2-3 kateshe